



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:222674

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05468989

**P.nr.2023:222675**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.D., me vendbanim në Ferizaj, Rruga “ ... “, nr.55, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së ( Ligji nr.06/L-074), sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II Nr.1777/2023 të datës 05.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Sadat Topalli të akuzuarit I.D., me datë 05.02.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Kundër të akuzuarit:**

- **I.D.**, me vendbanim në Ferizaj, Rruga “ ... “, nr.55, i lindur më .., nga i ati I. dhe e ëma S. e gjinisë A., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, beqar, me gjendje të dobët ekonomike, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, me nr. personal ..., mbrohet në liri,-

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

- Me 10 Tetor 2023, rreth orës 22:00, në rrugën “...”, në Ferizaj, saktësisht në marketin “S.V.”, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshme merr sendin e huaj, ashtu që hyn në market dhe nga aty merr 88 copë çokollata të cilat i ka futur nën rroba, ka kaluar arkën pa e bërë pagesën dhe derisa ka ka qenë duke dal nga marketi është ndaluar nga punëtori i sigurimit, vlera e dëmit të shkaktuar është 113.52 Euro,-

- **me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të neneve : 4, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe neneve 364, 449, 462 të KPP-së, të pandehurin e :

## **G J Y K O N**

- Të pandehurin **I.D.**, i shqipton Dënim me gjobë në shumë prej 150 Euro.-(njëqind e pesëdhjetë euro) të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 90 ditësh në tri këse mujore konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi dhe

- Me Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda kohës së verifikimit prej një (1) viti nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale si dhe

- Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një ditë burgim.

- Obligohet i pandehuri të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

- Pala e dëmtuar, Përfaqësuesi i të dëmtuarës “ S.V. ”, rruga “ ...mi ”, në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

## **A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj me datën 19.10.2023, Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, PP/II Nr.1518/2023 të datës 19.10.2023 kundër të akuzuarit I.D., me vendbanim në Ferizaj, Rruga “ ... ”, nr.... për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale me datën 05.02.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me pjesëmarrjen e Prokurori i Shtetit, Sadat Topalli dhe të akuzuarit I.D.. Përfaqësuesi i të dëmtuarës “ S.V. ”, rruga “ ... ”, në Ferizaj, është ftuar me ftesë të rregullt ku me datën 23.11.2023, ka pranuar ftesën, por nuk është paraqitur në seancën gjyqësore dhe mosardhjen nuk e ka arsyetuar.

Në bazë të neni 240, paragrafi 1 “ gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.”

Bazuar në Nenin 240 paragrafi 2 i KPP-së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), thuhet: *”Pala e dëmtuar ose viktimave dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës njoftohen për seancën e shqyrtimit fillestar dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm, **por mungesa e tyre nuk është pengës për mbajtjen e seancës**”.*

Gjykata konform nenit 241 paragrafi të KPP-së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), të akuzuarin, e ka udhëzuar për të drejtat e tija dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, i ka ofruar mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë.

I akuzuari I.D., deklaron e pranoj fajësinë për veprën penale për te cilën me ngarkon aktakuza, është e vërtetë që kam marrë produktet në market, kërkojë falje, kërkojë nga Gjykata që me rastin e dënimit të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, të dëmtuarit mbrojtësit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Sadat Topalli, lidhur me pranimin e fajësisë deklaron: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ky pranim është bere vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshme për pasojat e pranimin kjo ka mbështetje edhe ne provat tjera materialë tjera të lendes, kërkojmë nga gjykata qe të njëjtën ta shpalle fajtor dhe ta dënoj komfor ligjit duke pas parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese dhe me sanksionin e shqiptuar te arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nenit 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, të sqaruar edhe nga ana e gjykatës, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit Raporti fillestar i incidentit, deklarata e të pandehurit dhe deklarata e dëshmitarit Fatmir Shala, video-incizimi si dhe të shikohen shkresat të cilat gjenden në lëndë, dhe çdo provë tjetër të cilat gjenden në ketë lëndë dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk

ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës i akuzuar e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazëe tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari,ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 332 par. 4, të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 2 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vepra penale Vjedhja e përshkruar në nenin 313 të KPRK-së, i përcakton elementet themelore sipas së cilës në paragrafin 1 parashihet forma themelore e saj e që këtë vepër penale e kryen “Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet ...”, në rastin konkret përmbushen të gjitha elementet e figurës së veprës penale si marrja e pasurisë së huaj, këtë e ka pranuar i pandehuri e kjo vërtetohet edhe nga dëshmitari dhe provat tjera.

*Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana rënduese lidhur më këtë rast, gjykata vlerëson rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të akuzuarit në gjykatë, si dhe duke marrë parasysh keqardhjen e shprehur nga i akuzuari në seancë gjyqësore, dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, si dhe premtimin gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla. Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me kusht dhe më gjobë ndaj të pandehurit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën

e përgjegjësisë së tij, përveç kësaj gjykata ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të akuzuarin është i përballueshëm për kushtet ekonomike dhe të ardhurat që realizon nga puna e tij, pa rrezikuar mirëqenien e vet materiale. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i akuzuari të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është sjellë në bazë të nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 6, par. 1.5 dhe nenit 39, par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Ligjit nr.08 L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

**P.nr.2023:222675 me datë 19.03.2024**

**Zyrtare ligjore**

Arbelinda Tahiri

**Gjyqtari**

Adem Shabani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.